


# MBIKËQYRËSI SOCIAL

Angazhimi i Institucioneve  
për Politikat Sociale



## Rreth Mbikëqyrësit Social

Mbikëqyrësi Social është projekt i Institutit për Politika Sociale Musine Kokalari, i cili i mbledh të dhënat, shqyrton dhe analizon punën e deputetëve për nga aspekti sesa dhe si i diskutojnë politikat sociale gjatë punës në komisione dhe seanca parlamentare.

Qëllimi i këtij projekti është që përmes diskutimit publik ta sjellë në vëmendje rëndësinë e **Shtetit të Mirëqenies** për Republikën e Kosovës, si dhe të informojë në vazhdimësi qytetarët për sasinë dhe cilësinë e aktiviteteve të deputetëve dhe të grupeve parlamentare për politikat sociale.

Ky numër përmbledh punën e tremujorit të parë për vitin 2022 të Kuvendit. Publikimi i këtij raporti mbështetet nga Olof Palme International Center.



**E drejta autoriale ©2022** i takon IPS MUSINE KOKALARI. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem riprodhimi, apo të transmetohet në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik, apo mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi.

Përmbajtja e raportit është përgjegjësi vetëm e IPS Musine Kokalari dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Olof Palme International Center.

Rr. B, Residio 5  
Hy. 15-1, Dërvisholli  
10 000, Prishtinë  
Kosovë

[info@musineinsistute.org](mailto:info@musineinsistute.org)  
[www.musineinstitute.org](http://www.musineinstitute.org)

## PËRMBAJTJA

|  |    |
|--|----|
| 1. Përmbledhje .....   | 3  |
| 2. Aktiviteti në seancat parlamentare.....   | 5  |
| 3. Aktiviteti në komisionet parlamentare .....   | 10 |
| 4. Agjenda legjislative nga fusha sociale.....   | 15 |
| Metodologjia.....  | 16 |
| Referencat.....  | 17 |
| Aneksi 1 - Aktiviteti i deputetëve lidhur me 10 parimet e Shtyllës Evropiane për të Drejtat Sociale..... | 18 |
| Aneksi 2- Shtylla Evropiane e të Drejtave Sociale.....   | 20 |

## 1. Përmbledhje

Instituti për Politika Sociale Musine Kokalari përmes projektit **Mbikëqyrësi Social** ka ndjekur punën e deputetëve në seanca dhe në komisione parlamentare në tremujorin e parë të vitit 2022. Qëllimi parësor i këtij projekti është që të vë në pah sasinë e punës së deputetëve në raport me çështjet sociale, të cilat si parime të veçanta janë të bazuara në Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale (tutje: ShEDS), nismë e vitit 2017 nga Komisioni Evropian.

Hulumtuesit tanë kanë monitoruar aktivitetin e deputetëve bazuar në këto parime:

- Edukim dhe trajnim për tregun e punës;
- Mundësi të barabarta;
- Dialogu social dhe përfshirja e punëtorëve;
- Mbështetje për të papunët;
- Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara;
- Barazia gjinore;
- Siguria në punë;
- Kujdesi dhe mbështetja për fëmijët;
- Të ardhurat dhe pensionet e pleqërisë;
- Qasja në shërbimet thelbësore.

Gjithsej gjashtëmbëdhjetë (16) seanca parlamentare dhe tridhjetë (30) mbledhje të komisioneve parlamentare janë monitoruar.

Gjatë këtij tremujori, në seancat parlamentare deputetët kanë ngritur çështje nga fusha sociale **91 herë**, duke përfshirë deklaratimet jashtë rendit të ditës, pyetjet parlamentare dhe çështjet që janë lidhur me projektligje të caktuara. "Qasja në shërbimet thelbësore", "Dialogu social dhe përfshirja e punëtorëve" dhe "Barazia gjinore" kanë qenë parimet që janë diskutuar më së shumti, ndërsa për parimin "Edukim dhe trajnim për tregun e punës" nuk është diskutuar asnjëherë përgjatë kësaj periudhe.

Komisionet parlamentare, mbledhjet e të cilave janë monitoruar, janë këto:

- Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere;
- Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport;
- Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;
- Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Personat e Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione;
- Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Në gjithsej 30 mbledhje të këtyre komisioneve parlamentare, dhjetë parimet nga ShEDS janë diskutuar **27 herë**. Më së shumti janë ngritur çështje që lidhen me parimet "Kujdesi dhe mbështetje për fëmijët", "Mundësi të barabarta", "Edukim dhe trajnim për tregun e punës" dhe "Qasje në shërbimet thelbësore". Nuk ka pasur diskutime që prekin parimet "Dialogu social dhe përfshirja e punëtorëve" dhe "Mbështetje për të papunët".

Në vijim janë paraqitur të dhënat e detajuara të monitorimit për seancat dhe komisionet parlamentare, si dhe informacione rreth agjendës legjislative nga fusha sociale. Në Aneksin 1 të këtij publikimi është paraqitur aktiviteti i deputetëve në seanca parlamentare dhe në Aneksin 2 është paraqitur tabela e ShEDS.

## 2. Aktiviteti në seancat parlamentare

Në tremujorin e parë të vitit 2022, Kuvendi i Republikës së Kosovës mbajti gjithsej gjashtëmbëdhjetë (16) seanca, prej të cilave:

- 6 seanca të rregullta
- 7 seanca të jashtëzakonshme
- 3 seanca solemne

Përgjatë këtyre gjashtëmbëdhjetë seancave, 91 herë janë ngritur çështje të cilat lidhen me parimet e ShEDS. Parimet rreth të cilave deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë ngritur më së shumti çështje janë "Qasja në shërbimet thelbësore", "Barazia gjinore", "Mundësi të barabarta" dhe "Dialogu social dhe përfshirja e punëtorëve". Karakteristikë veçuese e këtij tremujori të parë është që tre nga shtatë seanca të jashtëzakonshme kanë prekur direkt çështjet që lidhen me parimet e ShEDS.

| 10 parimet e Shtyllës Evropiane për të Drejtat Sociale | Është diskutuar: |
|--|------------------|
| Qasja në shërbimet thelbësore                          | 26 x             |
| Barazia gjinore  | 19 x             |
| Dialogu social dhe përfshirja e punëtorëve             | 12 x             |
| Mundësi të barabarta                                   | 12 x             |
| Kujdesi dhe mbështetja për fëmijët                     | 7 x              |
| Mbështetje për të papunët                              | 6 x              |
| Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara          | 5 x              |
| Siguria në punë  | 2 x              |
| Të ardhurat dhe pensionet e pleqërisë                  | 2 x              |
| Edukim dhe trajnim për tregun e punës                  | 0 x              |
| <b>Totali:</b>   | <b>91 herë</b>   |

Tabela nr.1. Numri e çështjeve të ngritura që janë të lidhura me dhjetë parimet e ShEDS

Gjithsej 26 herë janë diskutuar çështje që lidhen me parimin "Qasja në shërbimet thelbësore". Respektivisht, çështja që është diskutuar më së shumti është ngritja e çmimeve të produkteve ushqimore në Kosovë. Diskutimet ishin të bazuara mbi trendet e rritjes së çmimeve, të evidentuara përmes Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), si mielli për 29%; buka për 17%; vaji për 46%; qumështi për 9%; patatet për 24% dhe nafta për 26% (ASK, 2021). Grupi parlamentar i LDK-së, PDK-së, dhe të AAK-së propozuan këto masa:

- Aktivizimin e inspektoratit të tregut kundër abuzimit me çmime;

- Funkcionalizimi i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për hetimin e marrëveshjeve të mundshme kartelë;
- Përgatitja e një pakoje fiskale që redukton ose largon tërësisht akcizën dhe zvogëlon TVSh-në për naftën për tre muajt e ardhshëm;
- Përgatitja e një pakoje ekonomike për t'u dalë në ndihmë qytetarëve dhe bizneseve;
- Qeveria t'i ndihmojë furnitorët në sigurimin e rezervave afatgjatë.

Rezoluta me këto propozime nuk morri vota të mjaftueshme (Kuvendi i Kosovës, 2022a).

Grupi parlamentar i PDK-së, LDK-së dhe AAK-së kërkuan dhe organizuan dy seanca të jashtëzakonshme për ta diskutuar shtrenjtimin e energjisë elektrike pas vendimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRë, 2022). Sipas këtij vendimi, të gjithë konsumatorët komercial dhe konsumatorët shtëpiak që shpenzojnë deri në 800 kV nuk do të kenë rritje të çmimit të energjisë elektrike, ndërsa rritja do të zbatohet për ata që tejkalojnë këtë kufi. Grupet parlamentare të lartëcektura propozuan një rezolutë duke kërkuar anulimin e vendimit të ZRRë-së, heqje të TVSh-së për energjinë elektrike deri në përfundim të krizës energjetike dhe themelimin e fondit për konsumatorët në nevojë (Kuvendi i Kosovës, 2022b). As kjo rezolutë me këto propozime nuk morri vota të mjaftueshme.

Gjatë seancave parlamentare në muajin janar dhe shkurt 2022, çështja e barazisë gjinore është diskutuar vetëm dy herë nga dy deputete. Arsyeja pse figuron si parim rreth të cilit janë ngritur më së shumti çështje është mbajtja e seancës së jashtëzakonshme për Ditën Ndërkombëtare të Gruas. Kjo seancë kishte vetëm një pikë të rendit të ditës "Ftesë Muzeut Kombëtar të Kosovës për krijimin e 5 hapësirave që njohin kontributin e grave në luftë". Përveç diskutimeve për këtë pikë, deputetet e Kuvendit kanë ngritur shqetësimin e tyre për nivelin e lartë të papunësisë së grave, ku vetëm 15.9% janë të punësuar dhe vetëm 22% aktive në tregun e punës (ASK, 2021). Rëndësi të veçantë i është dhënë edhe dhunës ndaj grave, përfshirë vrasjen e grave. Deputetja Tinka Kurti nga radhët e LVV-së theksoi se nga viti 2017 deri më 2021 janë vrarë gjithsej 76 gra në Kosovë. Deputetet vlerësuan se përkundër raportimit të dhunës nga viktimat, vrasjet vazhdojnë të ndodhin për arsye të neglizhencës së vazhdueshme nga organet e rendit për ndjekje dhe parandalim. Vetëm dy deputetë burra ngritën shqetësimin e tyre për pozitën e pabarabartë të grave në shoqëri.

"Dialogu social dhe përfshirja e punëtorëve" renditet si i treti parim për kah shumësia e çështjeve të ngritura në Kuvend gjatë këtij tremujori. Kjo është rezultat i rritjes së përgjithshme të kostos së shportës së konsumatorit, si dhe e rritjes së çmimit të energjisë elektrike, pasojë kjo e krizës ekonomike globale e shkaktuar nga invazioni i Rusisë në Ukrainë. Deputetët e Kuvendit kanë theksuar domosdoshmërinë e rritjes së pagës minimale, kërkesë kjo drejtuar qeverisë, për të përballuar trendin e inflacionit (qeveria kishte propozuar 264 euro, ndërkohë që sindikatat dhe disa prej partive opozitare kërkonin 400 euro). Deputeti Avdullah Hoti, nga radhët e LDK-së, ka propozuar që paga

minimale të indeksohet për t'iu përshtatur dinamikës fluide të inflacionit gjatë këtyre muajve të krizës (Kosova Press, 2022a). Një pjesë e konsiderueshme e diskutimeve në Kuvend, por edhe e temës në tërësi, ka qenë e fokusuar tek shuma mujore e pagës minimale dhe nuk ka pasur diskutim rreth ripërcaktimit të kriterëve bazë që përdoren për kalkulimin e saj. Shqetësimet në përgjithësi kanë qenë të fokusuara rreth urgjencës së përcaktimit të pagës minimale.

Në kuadër të diskutimeve për krizën ekonomike, deputetët e Kuvendit i janë drejtuar qeverisë me kërkesën që sa më parë ta sjellin projektligjin për pagat, që do t'i standardizonte pagat në sektorin publik. Qeveria ishte zotuar që do ta sjellë në Kuvend këtë projekt-ligj në muajin mars 2022 (Kuvendi i Kosovës, 2022c), por një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

Diskusimet në seancën parlamentare të mbajtur më 16 mars 2022, ku pikë e rendit të ditës ishte diskutimi në lexim të parë i Draft-Kodit Civil, janë kategorizuar si diskutime që lidhen me parimin "Mundësi të barabarta". Ndonëse Draft-Kodi Civil parasheh rregullimin dhe harmonizimin e dispozitave që lidhen me të drejtën detyimore, pronësore dhe trashëgimore, diskutimet janë përqëndruar te kapitulli i rregullimit të marrëdhënieve familjare. Kjo ndodhi për arsye se për herë të parë do të rregullohej bashkësia civile mes personave me seks të njëjtë. Duhet theksuar se dispozitat e këtij Draft-Kodi do të paraqisnin një avansim të të drejtave të komunitetit LGBTQI+. Megjithatë, ky avansim është jo i plotë sepse nuk njihet e drejta e martesës së personave me seks të njëjtë. Ky Draft-Kod bie në kundërshtim të drejtëpërdrejtë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila thotë që "çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje" (Kushtetuta e Kosovës, 2008), duke u njohur këtë të drejtë të gjithë qytetarëve pa kufizime gjinore.

Debati parlamentar ishte përqëndruar vetëm te kjo çështje. Diskutimi shkoi deri në përdorimin e hapur të gjuhës së urrejtjes dhe stigmatizimit ndaj personave LGBTQI+. Kryesisht në diskutim kanë marrë pjesë deputetët e LVV-së, grup parlamentar ky i ndarë në këtë çështje. Për sa kohë që grupi parlamentar i AAK-së dhe Grupi Multietnik kanë qenë hapur dhe shprehimisht kundër që qytetarët e Kosovës ta gëzojnë këtë të drejtë, grupi parlamentar i PDK-së dhe ai i LDK-së kanë mbajtur pozicion abstenues karshi çështjes duke e arsyetuar pozicionin e tyre me faktin që grupi më i madh parlamentar (i partisë që ka pushtetin) nuk i ka votat e mjaftueshme për ta kaluar ligjin.

Kryeministri Albin Kurti dhe Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë Albulena Haxhiu u kërkuan deputetëve që ta votojnë Draft-Kodin Civil duke thënë që votimi i tij përbën ngjarje të veçantë për Republikën e Kosovës, përmes të cilit do të plotësohen shumë mungesa ligjore nga fusha civile dhe u bënin thirrje që t'i shohin të drejtat e njeriut dhe avasimin e tyre në mënyrë universale, pra, për të gjithë (Kuvendi i Kosovës, 2022d).

Ndonëse monitoruesi nuk është i përqëndruar tek qëndrimet e qeverisë, është e rëndësishme të theksohet qëndrimi i saj në raport me këtë Draft-Kod. Po ashtu, meqë shumë deputet kanë përdorë gjuhë të urrejtjes gjatë deklarimeve të tyre, ato nuk janë përfshirë në numrin e përgjithshëm në ngritjen e çështjeve që lidhen me parimet e ShEDS.

Çështjet të cilat lidhen me parimin "Mbështetje për të papunët" janë diskutuar vetëm gjashtë (6) herë. Në janar është shqyrtuar Projektligji për Reformën e Sistemit të Ndhmës Sociale në Kosovë dhe gjatë seancës deputetët kanë ngritur shqetësime lidhur me mbështetjen për të papunët. Projekti për reformimin e sistemit të ndihmës sociale është marrëveshje ndërkombëtare mes Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Botërore, e cila arrin shifrën 47 milionë euro (RKS, 2022). Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, z.Hekuran Murati deklaroi se kjo marrëveshje do të ofrojë përforcimin e sistemit të mbrojtjes sociale dhe aktivizimin e përfituesve të kësaj skeme në tregun e punës; përmirësimin e performancës së skemës së ndihmës sociale; dhe sigurimin e kapaciteteve për implementimin dhe menaxhimin e projektit në vazhdimësi.

Grupi Parlamentar i LDK-së e kundërshtoi këtë projektligj me arsyetimin se asnjë nga qeveritë e mëparshme në Kosovë asnjëherë deri më tani nuk kanë marrë kredi për pagesë të skemave sociale. Sipas tyre, shteti duhet të jetë i aftë për mbledhjen e këtyre mjeteve dhe jo të hyjë në kredi ndërkombëtare. Ky projektligj nuk është miratuar si marrëveshje ndërkombëtare në mungesë të 80 votave të nevojshme. (Kosova Press, 2022b)

Çështjet të cilat lidhen me parimin "Kujdesi dhe mbështetje për fëmijët" janë diskutuar vetëm katër (4) herë. Deputetët kanë ngritur shqetësimin e tyre lidhur me fëmijët të cilët nuk kanë pasur mundësi që ta ndjekin mësimin online për shkak të pandemisë Covid-19; spitalin e ri të pediatri në QKUK i cili nuk është funksional nga muaji shtator i vitit 2021; dhe mosfillimin e punimeve për ndërtimin e 160 çerdheve për fëmijë, të zotuar në programin qeverisës.

Kërcënimet ndaj gazetarëve dhe siguria e punëtorëve shëndetësor kanë qenë çështjet e vetme të ngritura në kuadër të parimit "Siguria në punë". Niveli i ulët i të ardhurave të pleqërisë, që mbetet i pamjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve farmaceutike është ngritur dy herë si shqetësim, duke u ndërlidhur me parimin "Të ardhurat dhe pensionet e pleqërisë".

"Edukim dhe trajnim për tregun e punës" është parimi i vetëm nga fusha e të cilit nuk është diskutuar asnjë çështje në Kuvend gjatë këtij tremujori. Është mbajtur seancë e jashtëzakonshme për shënimin e Ditës së Mësuesit, e përqëndruar në mirënjohje të kontributit të mësuesve dhe nevojën për mbështetje më të madhe të tyre. Këto diskutime

nuk hyjnë në spektrin e parimit të lartëcektur. Sipas ShEDS ky parim thekson rëndësinë e një arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës dhe gjithashtu, tajnimet që ndihmojnë në krijimin e aftësive për një menaxhim më të suksesshem të tranzicionit në tregun e punës.

| 10 parimet e Shtyllës Evropiane për të Drejtat Sociale | LVV       | PDK       | LDK       | AAK       | LS       | Grupi Multietnik |
|--|-----------|-----------|-----------|-----------|----------|------------------|
| Qasja në shërbimet thelbësore                          | 3         | 10        | 8         | 3         | 0        | 2                |
| Barazia gjinore  | 10        | 4         | 2         | 3         | 0        | 0                |
| Dialogu social dhe përfshirja e punëtorëve             | 2         | 5         | 2         | 4         | 0        | 0                |
| Mundësi të barabarta                                   | 10        | 1         | 0         | 0         | 0        | 1                |
| Kujdesi dhe mbështetja për fëmijët                     | 2         | 3         | 1         | 0         | 0        | 0                |
| Mbështetje për të papunët                              | 0         | 3         | 3         | 0         | 0        | 0                |
| Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara          | 4         | 1         | 0         | 0         | 0        | 0                |
| Siguria në punë  | 0         | 2         | 0         | 0         | 0        | 0                |
| Të ardhurat dhe pensionet e pleqërisë                  | 0         | 1         | 0         | 1         | 0        | 0                |
| Edukim dhe trajnim për tregun e punës                  | 0         | 0         | 0         | 0         | 0        | 0                |
| <b>Totali:</b>   | <b>31</b> | <b>30</b> | <b>16</b> | <b>11</b> | <b>0</b> | <b>3</b>         |

Tabela nr.2. Tabela e ngritjes së çështjeve që lidhen me parimet e ShEDS sipas grupeve parlamentare

Në tabelën nr. 2 janë paraqitur të dhënat rreth çështjeve të ngritura që lidhen me parimet e ShEDS sipas grupeve parlamentare për tremujorin e parë të 2022. Sipas të dhënave, grupi parlamentar i LVV-së më së shumti ka ngritur çështje që lidhen me parimin "Barazia gjinore" dhe "Mundësi të barabarta". Grupi parlamentar i PDK, LDK dhe Grupi Multietnik më së shumti kanë ngritur çështje që lidhen me parimin "Qasje në shërbimet thelbësore", ndërsa Grupi parlamentar i AAK-së më së shumti ka ngritur çështje rreth parimit "Dialogu social dhe përfshirja e punëtorëve". Grupi Parlamentar i LS nuk ka ngritur asnjë çështje që lidhet me parimet e ShEDS.

| Partia: | Numri i deputetëve: | Aktiviteti në përqindje: |
|---------|---------------------|--------------------------|
| LVV     | 59                  | 35 %                     |
| PDK     | 18                  | 33 %                     |
| LDK     | 15                  | 17 %                     |
| AAK     | 8                   | 12 %                     |
| LS      | 11                  | 0 %                      |
| GM      | 8                   | 3 %                      |

Tabela nr.3. Tabela e ngritjes së çështjeve që lidhen me parimet e ShEDS sipas grupeve parlamentare me përqindje

Siç shihet nga tabela nr.2, Grupi parlamentar i LVV dhe PDK kanë sasi të përafërt të ngritjes së çështjeve nga fusha sociale, ndonëse dallojnë shumë për nga numri i deputetëve. Ky dallim mes numrit të deputetëve në grupe parlamentare dhe sasisë së aktivitetit të tyre në Kuvend është paraqitur në tabelën nr.3.

### 3. Aktiviteti në komisionet parlamentare

Në tremujorin e parë të vitit 2022 janë monitoruar 30 mbledhje dhe dy dëgjime publike të pesë komisioneve parlamentare të përzgjedhura (shih kapitullin Përmbledhje). Nga të dhënat e mbledhura rezulton se janë ngritur gjithsej 27 çështje që ndërlidhen me dhjetë parimet e ShEDS.

Më së shumti janë ngritur çështje që lidhen me parimet "Kujdesi dhe mbështetje për fëmijët", "Mundësi të barabarta", "Edukim dhe trajnim për tregun e punës" dhe "Qasje në shërbimet thelbësore". Nuk ka pasur diskutime që prekin parimet "Dialogu social dhe përfshirja e punëtorëve" dhe "Mbështetje për të papunët". Këto janë rezultatet e monitorimit:

- 4 herë është diskutuar për parimin "Kujdesi dhe mbështetja për fëmijët"
- 4 herë është diskutuar për parimin "Mundësi të barabarta"
- 4 herë është diskutuar për parimin "Edukim dhe trajnim për tregun e punës"
- 4 herë është diskutuar për parimin "Qasja në shërbimet thelbësore"
- 3 herë është diskutuar për parimin "Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara"
- 3 herë është diskutuar për parimin "Të ardhurat dhe pensionet e pleqërisë"
- 3 herë është diskutuar për parimin "Siguria në punë"
- 2 herë është diskutuar për parimin "Barazia gjinore"
- 0 herë është diskutuar për parimin "Dialogu social dhe përfshirja e punëtorëve"
- 0 herë është diskutuar për parimin "Mbështetje për të papunët"

Total: 27 diskutime që ndërlidhen me parimet e ShEDS.

| Mundësi të barabarta dhe qasje në tregun e punës  |                                    |                 |                      |                 |   |
|---|------------------------------------|-----------------|----------------------|-----------------|---|
| Komisionet parlamentare   | Edukim, trajnim për tregun e punës | Barazia gjinore | Mundësi të barabarta | Siguria në punë | Dialogu social, përfshirja e punëtorëve |
| Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere  | 0                                  | 0               | 0                    | 2               | 0                                       |
| Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport  | 4                                  | 0               | 0                    | 0               | 0                                       |
| Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim   | 0                                  | 0               | 0                    | 0               | 0                                       |
| Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione | 0                                  | 2               | 4                    | 0               | 0                                       |
| Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale  | 0                                  | 0               | 0                    | 1               | 0                                       |

Tabela nr. 4 Rezultatet nga monitorimi i komisioneve parlamentare për parimet në kundër të kapitullit "Mundësi të barabarta dhe qasje në tregun e punës"

| Mbrojtja dhe përfshirja sociale   |                                 |                           |                                       |   |                               |
|---|---------------------------------|---------------------------|---------------------------------------|---|-------------------------------|
| Komisionet parlamentare   | Kujdesi, mbështetja për fëmijët | Mbështetje për të papunët | Të ardhurat dhe pensionet e pleqërisë | Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara | Qasja në shërbimet thelbësore |
| Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere  | 0                               | 0                         | 2                                     | 0   | 0                             |
| Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport  | 1                               | 0                         | 0                                     | 0   | 0                             |
| Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim   | 0                               | 0                         | 0                                     | 0   | 0                             |
| Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione | 2                               | 0                         | 1                                     | 3   | 0                             |
| Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale  | 1                               | 0                         | 0                                     | 0   | 4                             |

Tabela nr. 5 Rezultatet nga monitorimi i komisioneve parlamentare për parimet në kuadër të kapitullit "Mbrojtja dhe përfshirja sociale"

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere ka ftuar për raportim kryetarin e bordit dhe përfaqësues të menaxhmentit të RTK-së. Deputetët e komisionit kanë kërkuar sqarim lidhur me të punësuarit aktual që i takojnë komunitetit serb, të cilët janë me kontrata të veçanta pune, por që ende nuk iu është verifikuar diploma e studimeve. Përfaqësuesit e RTK-së theksuan që vonesa e verifikimit të diplomave është pasojë e mosfunksionalizimit të zyrës përkatëse për verifikim. Meqë barra e kësaj çështjeje nuk bie mbi ta, menaxhmenti konsideron se nëse vazhdojnë të veprojnë në këtë mënyrë siç ka qenë deri tani, atëherë do të diskriminohen ata që kanë diploma të verifikuara dhe kjo do të paraqiste shkelje ligjore. Kjo çështje është diskutuar në dy mbledhje dhe ndërlihet me parimin "Siguria në punë".

Në mbledhjen e datës 16 shkurt 2022, komisioni diskutoi për Projektligjin nr.08/L-126 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Sigurime Shoqërore në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, ku ka qenë i ftuar Ministri për Buxhet, Punë dhe Transfere, z.Hekuran Murati. Deputetët kanë kërkuar sqarime lidhur me formulimet gjuhësore të neneve të caktuara dhe lidhur me paqartësitë në raport me gjuhët zyrtare dhe çështjen e valutës e cila do të përdorej në Kosovë ose në Shqipëri. Gjatë kësaj mbledhje, Ministri Murati nuk i është përgjigjur kërkesave të deputetëve. Meqë projektligji i diskutuar rregullon çështjet e punësimit dhe pensioneve për shtetasit e Kosovës që kontribuojnë në Shqipëri dhe anasjelltas, ky diskutim është konsideruar të jetë i ndërlihet me parimin "Të ardhurat dhe pensionet e pleqërisë". I njëjti parim preket edhe nga diskutimi i Komisionit me bordin e Trustit Pensional të Kosovës, takim gjatë të cilit është kërkuar vlerësimi i këtij bordi rreth ndikimit që do të mund të kishte një tërheqje

eventuale e dytë e mjeteve të kursyera si masë emergjente për shkak të krizës ekonomike, me ç'rast përfaqësuesit e Trust-it janë deklaruar se ende nuk është bërë një vlerësim i tillë.

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini Dhe Sport ka diskutuar Projektligjin nr.08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në katër mbledhje, ku kanë raportuar Ministrija e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, znj.Arbërie Nagavci, Këshilli Shtetëror i Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe eksperti ndërkombëtar z.Bastian Bauman. Gjatë këtyre mbledhjeve deputetët e komisionit kanë ngritur çështje të ndryshme që ndërlidhen me nenet e projektligjit të lartpërmendur, ankesat për mosakreditimin e disa programeve më 2021 dhe kanë shtruar pyetjen nëse është bërë vlerësimi i akreditimit të programeve në raport me nevojat e tregut të punës. Për këtë të fundit, përfaqësuesit e KShC janë deklaruar se nuk është bërë një analizë e tillë. Kjo temë është diskutuar gjithsej katër herë dhe është e ndërlidhur me parimin "Edukim dhe trajnim për tregun e punës".

Komisioni për Arsim në bashkëpunim me Koalicionin e OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve kanë organizuar tryezën me temën "Integrimi i politikave dhe shërbimeve për trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve me fokus në shkolla". Deputetët e komisionit kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me sigurinë e fëmijëve dhe kanë përmendur këto çështje që mund të ndërlidhen qoftë si shkak, qoftë si pasojë, të fenomenit të dhunës në shkolla: niveli i varfërisë së nxënësve, shumë prej të cilëve janë të përfshirë jashtëligjshëm në punë; mosvijueshmëria e mësimeve në edukimin e hershëm dhe cilësia e dobët e arsimit; fenomenet si bullizmi, stigmatizimi, diskriminimi në baza gjinore, etnike dhe të prejardhjes. Ministrija e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, znj.Arbërie Nagavci, ka shprehur shqetësimin e saj lidhur me mungesën e raportimeve për rastet e dhunës. Ajo ka theksuar po ashtu se grantet e parapara për punësimin e psikologëve dhe pedagogëve në shkolla, komunat i kanë përdorur për punësim të kuadrove të tjera. Diskutimet e kësaj tryeze, ndonëse të shumta, të gjitha prekin parimin "Kujdesi dhe mbështetja për fëmijët", e si rrjedhojë numërohen si parim i diskutuar një herë.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka dështuar t'i mbajë mbledhjet për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione, ka mbajtur gjithsej gjashtë mbledhje dhe një dëgjim publik. Gjatë këtyre mbledhjeve është diskutuar për monitorimin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, ku fillimisht kanë raportuar Avokati i Popullit, përfaqësuesi i Zyrës së Qeverisjes së Mirë, kryeshefja ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore dhe drejtori i Zyrës Ligjore të Zyrës së Kryeministrisë.

Janë problematizuar aspekte të ndryshme procedurale rreth zbatimit të këtij ligji nga ana e institucioneve dhe gjyqësorit. Në mbledhjen e radhës kanë raportuar përfaqësuesit nga zyra e Inspektoratit të Punës, përfaqësues të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas ku është diskutuar për numrin e madh të ankesave të qytetarëve të cilët e bazojnë ankesën e tyre te dispozitat e Ligjit të Punës dhe jo te Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi. Deputetët kanë ngritur çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me numrin e grave dhe minoriteteve që janë të angazhuar në Inspektoratin e Punës dhe angazhimin e këtyre institucioneve raportuese për zbatimin e këtij ligji. Komisioni ka ftuar edhe kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për raportim për të njëjtën çështje. Deputetët kanë shprehur shqetësimin e tyre që gjykatat nuk kanë as edhe një rast të vetëm ku i referohen Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Kryesuesi i KGJK-së e arsyetoi këtë për faktin që nëse një çështje cilësohet si çështje nga marrëdhënia e punës, atëherë edhe trajtohet sipas Ligjit të Punës. Deputetët e komisionit kanë ngritur edhe çështjen e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, si gjatë procedurave gjyqësore, ashtu edhe në raport me punësimin e tyre në gjyqësor. Po ashtu, ata kanë shprehur shqetësimin e tyre me trajtimin e rasteve të vrasjes së grave dhe dënimeve të ulta për kryesit e këtyre veprave.

Në dy mbledhjet e muajit mars është diskutuar për çështjet që lidhen me plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve, problemin e dhunës në shkolla, si dhe për nivelin e zbatimit të Strategjisë Nacionale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Për këto tema, Komisioni ka ftuar për raportim përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe zv.Ministren e Ministrisë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në cilësinë e Koordinatorës Nacionale për Mbrojtje ndaj Dhunës në Familje, znj.Nita Shala. Deputetët kanë ngritur çështje dhe kanë shtruar pyetje lidhur me mundësinë e përfshirjes së një moduli mësimor kundër dhunës në shkolla, mekanizmat ekzistues të Ministrisë së Arsimit për riedukimin e nxënësve që ushtrojnë dhunë, mbrojtjen e fëmijëve viktime, problemin e ndërtimit të objekteve shkollore të niveleve të ndryshme arsimore në hapësira të njëjta dhe përdorimi i narkotikëve nga nxënësit. Të gjitha këto janë të ndërlidhura me parimin "Kujdesi dhe mbështetja për fëmijët". Sa i përket diskutimit për problemin e dhunës në familje, deputetët kanë propozuar që gratë, gjatë kohës së qëndrimit të tyre në strehimore, të mbështeten me lehtësira tatimore.

Duke qenë se komisioni ka diskutuar për tema të caktuara disa mbledhje me radhë dhe kanë ngritur çështje të ndryshme brenda atyre temave, gjithsej janë ngritur katër çështje që ndërlidhen me parimin "Mundësi të barabarta", dy çështje që ndërlidhen me parimin "Barazia gjinore", gjashtë çështje nga "Kujdesi dhe mbështetja për fëmijët" dhe tri çështje nga "Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara".

Komisioni për të Drejtat e Njeriut në takimin me përfaqësuesit e punëtorëve të Ndërmarrjes "19 Qershori" në Podujevë është zotuar se do t'iu ndihmojnë punëtorëve në

në adresimin e kërkesave të tyre për kompensimin e të ardhurave personale me ç'rast kanë prekur parimin "Të ardhurat dhe pensionet e pleqërisë".

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka shqyrtuar raportin e grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shëndetin Mendor, të gjeturat kryesore e të cilit janë: mos-hartimi i akteve nënligjore dhe i Planit Strategjik për Shëndetin Mendor nga Ministria e Shëndetësisë, mosfunksionalizimi i departamentit për shëndet mendor në kuadër të Ministrisë dhe mosaprovimi i udhërrëfyesit klinik për shëndetin mendor. Deputetët kanë ngritur shqetësimin e tyre për ngecjen e punës së Ministrisë dhe kanë problematizuar mungesën e barnave, stafit dhe buxhetit për ta trajtuar këtë çështje. Në kuadër të raportit, Komisioni ka propozuar 11 rekomandime për Ministrinë e Shëndetësisë.

Ministri i Shëndetësisë ka raportuar në dy mbledhje të Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Gjatë këtyre dy takimeve, deputetët kanë ngritur çështje që kanë të bëjnë me menaxhimin e Pandemisë Covid-19, numrin e mjekëve të infektuar dhe ndikimin në ofrimin e shërbimeve për pacientët, mungesën e stafit në repartin e kujdesit intensiv, mosfunksionalizimin e spitalit të pediatriisë, mungesën e barërave dhe listën e gjatë të pritjes për operime dhe diagnostifikim. Komisioni ka realizuar një takim me Bordin Drejtues të SHSKUK-së, ku kanë diskutuar shqetësimet e lartëcektura. Meqë nuk ka qenë takim publik, nuk mund të bëjmë vlerësim të çështjeve që janë diskutuar. Në mbledhjen pasuese të Komisionit, deputetët kanë shprehur pakënaqësinë e tyre me këtë bord dhe kanë përmendur përsëri listën e gjatë të pritjeve për operime duke thënë që nuk mund të përdoret si arsyetim Pandemia Covid-19. Po ashtu, ata kanë shprehur shqetësimin e tyre që keqmenaxhimi i sektorit publik po bëhet me qëllim që të fitojë sektori privat.

Mungesa e Planit Strategjik për Shëndetin Mendor, mungesa e stafit mjekësor, barërave dhe lista e gjatë e pritjes për operime dhe diagnostifikim janë katër çështje që prekin parimin "Qasje në shërbimet thelbësore". Sfida e numrit të punëtorëve shëndetësor të diagnostifikuar me Covid-19 është e ndërlidhur me parimin "Siguria në punë" dhe problematizimi i mosfunksionalizimit të spitalit të pediatriisë është i ndërlidhur me parimin "Kujdesi dhe mbështetja e fëmijëve". Ky komision nuk ka diskutuar çështje të tjera që ndërlidhen me mirëqenien sociale.

## 4. Agjenda legislative nga fusha sociale

Me 16 janar 2022, në mbledhjen e saj të 56-të, Qeveria e Kosovës e miratoi Programin Legjislativ për vitin 2022 (Qeveria e Kosovës, 2022a), që u ndryshua dhe plotësua më 24 shkurt 2022 (Qeveria e Kosovës, 2022b). Ky program përfshin në total 133 projektligje të parapara për t'u trajtuar e proceduar këtë vit, prej të cilave 11 projektligje i takojnë fushës sociale. Sipas agjendës legislative, një projektligj do të trajtohet në muajin prill, katër në qershor, një në shtator, dy në tetor dhe tre në muajin nëntor:

| Nr. | Projektligji   | Data për dërgim në Kuvend | Shqyrtim në komisione | Leximi i parë | Shqyrtimi i amandamenteve në komisione | Leximi i dytë |
|-----|--|---------------------------|-----------------------|---------------|--|---------------|
| 1   | Projektligji për Vlerësimin, Njohjen e Statusit, Përfitimet dhe Shërbimet për Personat me Aftësi të Kufizuar   | 30.04.2022                |                       |               |  |               |
| 2   | Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomik-Social  | 30.06.2022                |                       |               |  |               |
| 3   | Projektligji për Inspektoratin e Punës   | 30.06.2022                |                       |               |  |               |
| 4   | Projektligji i Punës   | 30.06.2022                |                       |               |  |               |
| 5   | Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë   | 30.06.2022                |                       |               |  |               |
| 6   | Projektligji për Banim Social  | 10.09.2022                |                       |               |  |               |
| 7   | Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-205 për Agjencinë e Punësimit  | 20.10.2022                |                       |               |  |               |
| 8   | Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga MFPT dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës për projektin e Banimit Social | 31.10.2022                |                       |               |  |               |
| 9   | Projektligji për Skemën e Ndhmës Sociale   | 25.11.2022                |                       |               |  |               |
| 10  | Projektligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare   | 25.11.2022                |                       |               |  |               |
| 11  | Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti   | 25.11.2022                |                       |               |  |               |

Tabela nr. 5 Agjenda legislative nga fusha sociale për vitin 2022

Të gjitha projektligjet e përmendura do të monitorohen gjatë këtij viti nga Instituti për Politika Sociale Musine Kokalari. Përzgjedhja e tyre është bërë duke pasur parasysh 10 parimet nga ShEDS.

## Metodologjia

Instituti për Politika Sociale Musine Kokalari ka krijuar një matricë të monitorimit të aktivitetit të deputetëve në seanca dhe në komisione parlamentare, duke u bazuar në Shtyllën Evropiane për të Drejtat Sociale (shih Aneksin nr. 2). Nga gjithsej 20 parime, hulumtuesit tanë kanë përzgjedhur 10 prej tyre, të cilat janë vlerësuar me interes të veçantë (shih kapitullin Përmbledhje).

Monitorimi i seancave parlamentare është bërë nëpërmjet ndjekjes së mbledhjeve që transmetohen online. Në rast të paqartësive dhe rikonfirmimeve janë konsultuar procesverbalet. Komisionet janë monitoruar nëpërmjet pjesëmarrjes fizike në mbledhje dhe nëpërmjet procesverbaleve.

Aktiviteti i deputetëve dhe i grupeve parlamentare në seanca plenare është hulumtuar sipas secilit fjalim individual. Në cilëndo formë që është ngritur ndonjë çështje e cila ndërlihet me dhjetë parimet e ShEDS, si fjalimet, deklaratimet jashtë rendit të ditës, replikat apo pyetjet, ato janë konsideruar si çështje e ngritur një herë. Duke qenë se diskutimet në komisione parlamentare janë më të zgjeruara, vlerësimi është bërë për komisionin si tërësi, por jo edhe si diskutime të deputetëve në veçanti. Nëse një temë është diskutuar në më shumë se një mbledhje, atëherë ajo është cilësuar si çështje e ngritur më shumë se një herë. Nëse brenda mbledhjes së njëjtë është diskutuar për temën e njëjtë, por që kanë prekur çështje të ndryshme, atëherë edhe kjo është numëruar si çështje e ngritur më shumë se një herë.

Çdo vërejtje, koment dhe sugjerim janë të mirëseardhura në adresën përkatëse elektronike : [info@musineinstitute.org](mailto:info@musineinstitute.org).

## Referencat

ASK (2021), Anketa e Fuqisë Punëtore 2021. Marrë nga: <https://bit.ly/36GSExQ>

Komisioni Evropian (2017), European Pillar of Social Rights, link: [https://ec.europa.eu/info/strategy/priorities-2019-2024/economy-works-people/jobs-growth-and-investment/european-pillar-social-rights/european-pillar-social-rights-20-principles\\_en](https://ec.europa.eu/info/strategy/priorities-2019-2024/economy-works-people/jobs-growth-and-investment/european-pillar-social-rights/european-pillar-social-rights-20-principles_en), Qasja: 31 mars 2022

Kosova Press. (2022a), Hoti del me propozime për tejkalimin e krizës së çmimeve e pasojave sociale, link: <https://kosovapress.com/hoti-del-me-propozime-per-tejkalimin-e-krizes-se-cmimeve-e-pasojave-sociale/>, Qasja: 28 mars 2022

Kosova Press. (2022b), Kuvendi nuk e miraton marrëveshjen ndërkombëtare për reformen e sistemit të ndihmës sociale, link: <https://kosovapress.com/%E2%80%8Bkuvendi-nuk-miraton-marreveshjen-nderkombetare-per-reformen-e-sistemit-te-ndihmes-sociale/>

Kushtetuta e Kosovës (2008), link: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

Kuvendi i Kosovës (2022a), Transkript i mbledhjes më 15 mars dhe 14 prill 2022, link: [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2022\\_03\\_15\\_ts\\_Seanca\\_3Ëe6gCD9Jg.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2022_03_15_ts_Seanca_3Ëe6gCD9Jg.pdf)

Kuvendi i Kosovës (2022b), Propozim Rezoluta e GP të PDK-së,, LDK-së dhe AAK-së në Seancë të Jashtëzakonshme, link: [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2022\\_02\\_09\\_ts\\_Seanca\\_mn34NtVfmT.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2022_02_09_ts_Seanca_mn34NtVfmT.pdf) fq. 62, Qasja: 28 mars 2022

Kuvendi i Kosovës (2022c), Fjala e Ministrit për Punë të Brendshme dhe Administratë Publike Xhelal Sveçla në seancën e rregullt plenare, link: [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2022\\_01\\_20\\_ts\\_Seanca\\_8NUmt9YËhM.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2022_01_20_ts_Seanca_8NUmt9YËhM.pdf) fq. 39, Qasja: 29 mars 2022

Kuvendi i Kosovës (2022d), Transkript i mbledhjes më 24 dhe 25 shkurt, 15 mars dhe 14 prill 2022, link: [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2022\\_02\\_24\\_ts\\_Seanca\\_mXfSULNMhc.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2022_02_24_ts_Seanca_mXfSULNMhc.pdf)


Qeveria e Kosovës (2022a), Programi Legjislativ për vitin 2022, link: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/01/Vendimet-e-Mbledhjes-se-56-te-te-Qeverise-se-Republikes-se-Kosoves-1.pdf> Qasja: 10 mars 2022


Qeveria e Kosovës (2022b), Programi Legjislativ për vitin 2022, link: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/02/Vendimet-e-mbledhjes-se-63-te-te-Qeverise.pdf> Qasja: 10 mars 2022

RKS (2022), Marrëveshja ndërkombëtare për reformen e sistemit të ndihmës sociale, link: [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Marreveshja\\_compressed\\_vws35xnLA.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Marreveshja_compressed_vws35xnLA.pdf)


ZRrE (2022), Është mbajtur seanca e (IV) e Bordit të ZRRE, link: <https://www.ero-ks.org/zrre/sq/eshte-mbajtur-seanca-e-iv-e-bordit-te-zrre>


## Aneksi 1 - Aktiviteti i deputetëve lidhur me 10 parimet e Shtyllës Evropiane për të Drejtat Sociale





## Aneksi 2- Shtylla Evropiane e të Drejtave Sociale





**MK**

INSTITUTI  
PËR  
POLITIKA  
SOCIALE

©IPSMusineKokalari  
Prill, 2022  
Prishtinë